

BULETIN INFORMATIV

Janar - Dhjetor 2008

KOMISIONI PËR EKONOMI, TREGTI, INDUSTRI,
ENERGJETIKË, TRANSPORT DHE TELEKOMUNIKACION



Kuvendi i Republikës
së Kosovës



Janar - Dhjetor 2008



Fjala hyrëse e Kryetares së Komisionit



Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Enerjetikë, Transport dhe Telekomunikacion është Komision funksional i Kuvendit, i cili mbulon punën e katër ministrive në lëmin e ekonomisë. Ky është një fakt i mjaftueshëm që tregon punën e vëllimshme që ka ky Komision brenda fushëveprimtarisë së vet.

Gjatë vitit 2008, komisioni ka shqyrtuar të gjitha projektligjet që i përkasin fushës së tij.

Gjithashtu, Komisioni ka shqyrtuar një numër të kërkesave të Qeverisë dhe agjencioneve tjera drejtuar këtij Komisioni. Në kuadër të aktiviteteve të tij, Komisioni ka realizuar disa vizita në terren, të cilat janë lidhur drejtpërdrejtë me objektivat dhe përgjegjësitë e tij.

Përbërja e Komisionit përfaqëson shumicën e subjekteve pjesëmarrëse në Kuvend, i cili dominohet nga partitë në pushtet, mirëpo që udhëhiqet nga partitë opozitare. Anëtarët e Komisionit i përkasin fushave që mbulon ky Komision dhe janë shumë profesional në punën e tyre. Gjatë mbledhjeve diskutimet janë të hapura, gjatë të cilave zhvillohen debate shumë profesionale që rezultojnë me përfundime të suksesshme.

Duke qenë se, Komisioni është trup punues profesional i Kuvendit, nevojat për ekspertiza në të ardhmen po bëhen gjithnjë e më të nevojshme. Vetëm mbi bazën e ekspertizave profesionale, për ndonjë fushë apo materie të caktuar, mund të ndërtohet legjislacioni i përshtatshëm dhe kompatibil me standardet evropiane, si parakusht i zhvillimit ekonomik të Kosovës. Nevoja për ekzistimin e një Rregullore të veçantë për punën e Komisioneve parlamentare, do ta bënte më intensive dhe më racionale punën e Komisionit, në të ardhmen.

Myzejane Selmani

Kryetare e Komisionit



Fushëveprimtaria e Komisionit

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion në kuadër të fushëveprimtarisë së tij, angazhohet për përcaktimin dhe përcjelljen e zbatimit të politikave të përgjithshme në fusha të ekonomisë, tregtisë, industrisë, energjetikës, transportit dhe telekomunikacionit në Kosovë, të cilat udhëhiqen nga Institucionet e Republikës së Kosovës.



Për konceptimin e strategjisë së përgjithshme për zhvillimin e këtyre veprimtarive ekonomike ndërmjet Kosovës dhe autoriteteve tjera, komisioni bënë rekomandime për Kuvendin, Ministritë përkatëse etj., në krijimin e infrastrukturës ligjore për një ambientit më të sigurt për investime, për marrëveshje

tregtare, për koncesione në infrastrukturë, energjetikë, resurse minerale dhe çështjet të tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin e këtyre degëve ekonomike.

Plani i Punës për vitin 2008

Në bazë të Strategjisë Legjislative të Qeverisë, në fillim të vitit 2008, Komisioni për ETIETT ka miratuar Planin e Punës në bazë të të cilit ka zhvilluar aktivitetet e tij.

Plani i Punës ka paraparë që Komisioni, gjatë vitit 2008: të angazhohet në ndërtimin e infrastrukturës ligjore nën juridiksionin e tij, të grumbulloj informata përmes dëgjimeve publike dhe formave tjera të bashkëpunimit me qëllim të hartimit sa më të mirë të projektligjeve, të formojë nën grupe punuese sipas nevojës, të monitoroj implementimin e zbatimit të së paku një ligji, të bashkëpunoj ngushtë me institucionet e Kosovës dhe organizatat relevante ndërkombëtare, të punoj në ngritjen e cilësisë së punës dhe bashkëpunimit intern duke përfshirë edhe stafin mbështetës dhe të përmirësoj vizibilitetin e Komisionit dhe komunikimin me qytetarë.



Takimet e Komisionit

Komisioni për ETIETT, gjatë vitit 2008, ka mbajtur gjithsej *29 mbledhje të rregullta*. Gjatë këtyre takimeve, Komisioni ka shqyrtuar Projektligjet që kanë qenë në procedurë dhe kërkesat e parashtruara nga Qeveria si dhe agjensionet tjera. Për të gjitha projektligjet Komisioni ka përgatitur raporte me amendamente, të cilat i janë rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.



Për të qenë sa më efektiv, Komisioni ka formuar *10 grupe punuese*, për secilin Projektligj nga një, të cilat kanë përgatitur amendamente për komisionin.

Me ftesë të Komisionit në takime kanë prezantuar përfaqësues të Qeverisë dhe agjensioneve tjera qeveritare dhe jo qeveritare. Gjithashtu, takimet e Komisionit kanë qenë të hapura dhe janë përcjellur nga monitorues vendor dhe ndërkombëtar si dhe mediat. Në mbledhjet e Komisionit janë zhvilluar debate dhe diskutime brenda standardeve demokratike.

Shqyrtimi i projektligjeve

Gjatë vitit 2008, Komisioni për ETIETT, ka shqyrtuar gjithsej *10 projektligje*. Ato janë:

- Projektligji për Ngrohje Qendrore;
- Projektligji për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme;
- Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rrugët;
- Projektligji për Eficiência e Energjisë Elektrike;
- Projektligji për Akreditim;
- Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Kërkesat Teknike për Produktet dhe Vlerësimin e Konformitetit;
- Projektligji për Shpronësim;
- Projektligji për Masat Anti Dumping;
- Projektligji për Ndryshimin e Taksës së Vendosjes;
- Projektligji për Ujëra të Zeza dhe Mbeturina;

Gjatë shqyrtimit të këtyre projektligjeve, Komisioni ka ftuar sponsoruesit e këtyre projektligjeve (përfaqësuesit e Qeverisë) dhe ka pranuar ekspertizë të cilën e kanë ofruar organizatat e ndryshme ndërkombëtare.



Monitorimi i zbatimit të ligjit

Duke u bazuar në nenin 53 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni ka autoritet të mbikëqyr zbatimin e ligjeve nga Qeveria e Kosovës ose nga Ministria përkatëse. Qëllimi i mbikëqyrjes është verifikimi i zbatueshmërisë së ligjeve, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së përgjithshme në fushën që e mbulon ligji.



Në bazë të autoritetit që ka, Komisioni për ETIETT, ka zgjedhur të monitoroj zbatimin e *Ligjit për Rrugët*. Komisioni, i mbështetur nga stafi dhe NDI, ka hartuar Planin e Monitorimit dhe Planin e Veprimit, në bazë të të cilëve janë zhvilluar aktivitetet e monitorimit të zbatimit të ligjit.

Deri tani, në kuadër të monitorimit të ligjit, Komisioni ka zhvilluar takime me përfaqësuesit e Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, si dhe zhvilluar vizitë në Komunën e Gjakovës, me ç'rast janë takuar me përfaqësuesit e Kuvendit Komunal. Me rastin e vizitës në komunën Gjakovës, Komisioni ka vëzhguar punimet e rrugës së Dushkajës.

Procesi i monitorimit të Ligjit për Rrugët është duke vazhduar, ku pas përfundimit të vizitave në terren, Komisioni do të përgatisë një raport me rekomandime të cilin do t'ia rekomandoj Kuvendit për shqyrtim.





Vizitat e Komisionit

Përveç shqyrtimit të projektligjeve, Komisioni ushtron edhe funksionin e mbikëqyrjes së punës së institucioneve ekzekutive dhe adresimin e problemeve, me të cilat përballen ato. Komisioni ka realizuar dy vizita në terren për të njohur më mirë nivelin e zbatimit të ligjeve. Gjatë këtij viti, Komisioni ka vizituar Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës dhe Korporatën Energjetike të Kosovës. Në këto vizita, anëtarët e Komisionit, për së afërmi u njoftuan me problemet dhe shqetësimet e këtyre ndërmarrjeve publike, të cilave ju kanë premtuar se do t'i përcjellin në Kuvend.

Raportimi i ministrave në Komision

Gjatë vitit 2008, në Komisionin për ETIETT, kanë raportuar disa herë zyrtarët e ministrive që mbulojnë nga ky komision.

Për çështjen e kërkesës për privatizimin e Distribucionit të KEK-ut nga Ministria për Ekonomi dhe Financa ka prezantuar Ministri z. Ahmet Shala dhe zv. Bedri Hamza. Për të njëjtën çështje para Komisionit ka prezantuar Ministri për Energji dhe Miniera znj. Justina Pula.

Ndërsa, për çështjen e monitorimit të zbatimit të *Ligjit për Rrugët* para Komisionit ka prezantuar Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, z. Fatmir Limaj dhe zv. Adem Grabovci.

Statistika

- Mbledhje të komisionit	29
- Projektligje të shqyrtuara	10
- Grupe punuese të formuara	10
- Takime të grupeve punuese	27
- Monitorimi i ligjeve	1
- Vizita në terren	3
- Raportimi i ministrave në takime	mbi 7
- Dëgjime publike	Asnjë

PËRBËRJA E KOMISIONIT



Myzejone Selmani – AKR
Kryetare e Komisionit



Ethem Çeku – AAK
Zëvendëskryetar i Parë



Slobodan Petrovic – SLS
Zëvendëskryetar i Dytë



Kaqusha Jashari – PDK
Anëtare



Safete Hadërgjonaj – PDK
Anëtare



Haki Shatri – LDK
Anëtar



Fatmir Rexhepi - LDK
Anëtar



Sala Berisha – Shala – PDK
Anëtare



Zef Morina – LDK
Anëtar



Berim Ramosaj – LDD
Anëtar



Mufera Shimik – 7+
Anëtare



Kontaktet

Marrëdhëniet me Publikun

Sherif Konjufca

Shef i Seksionit

Zyra N - 08, Kati përthjes

038 211 186

sherif.konjufca@assembly-kosova.org

Stafi mbështetës i Komisionit

Hasan Tahiri

Administrator i zyrës

038 211 297

hasan.tahiri@assembly-kosova.org

Advie Morina

Zyrtare e Lartë Ligjore

038 211 185

advie.morina@assembly-kosova.org

Armend Ademaj

Zyrtar Ligjor

038 213 801

armend.ademaj@assembly-kosova.org

Besim Haliti

Nëpunës Administrativ

038 211 838

besim.haliti@assembly-kosova.org

Zyrtare nga NDI që mbështet Komisionin

Blerina Uka

Zyrtare Legjislative

Zyra N - 320, Kati III

038 212 532

blerinauka5@gmail.com

044 513 655

Webfaqja e Kuvendit

www.kuvendikosoves.org

Përkrahur nga:

